



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:074567

Datë: 29.05.2019

Numri i dokumentit: 00335165

P.nr.123/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Donika Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurve R. A. për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati..., të pandehurit A. R., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati..., nga ... dhe të pandehurit Xh.A., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati..., duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.143/2019, të datës 31.01.2019, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimi fillestar, mori dhe publikisht me datën 22.05.2019, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

R... A..., nga babai Xh... dhe nëna S..., e lindur I..., i lindur me datë..., në Gj..., ku edhe jeton në rrugën “”, nr. ...., ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

A. R, nga babai A... dhe nëna I..., e lindur A..., i lindur me datë..., në Gj..., ku edhe jeton në rrugës “...”, nr..., student në vitin e dytë në..., drejtimi Banka Financa dhe Kontabilitet, i martuar, baba i dy fëmijeve, i punësuar në firmë “...” në Gj..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

Xh. A..., nga babai N.... dhe nëna F..., e lindur S... ,i lindur me datë, në Gj..., ku edhe jeton në lagjen ....në rrugën “.....” me numër ...., ka të kryer shkollën fillore , i martuar, baba i katër fëmijeve, i pa punë, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

I.

I pandehuri .....

Sepse me datë 26.01.2019, rreth orës 01:45 minuta, në kafiterinë “....”, në lagjen “....”, në Gj....., i pandehuri R.... A.... me dashje dhe me përdorimin e atëqastshëm të dhunës ka përdorur forcën ndaj personit tjetër, ashtu që për shkak të një mosmarrëveshje në mes vete i njejt fillimisht e fyen me fjalë të ndryshme ofenduese e më pas të dëmtuarin .....e sulmon duke e shtyer dhe duke e kapur për gjoksi, e tërheq për ta nxjerrë nga lokali mirëpo ndërhyjnë personat që kanë qenë prezent dhe e largojnë të njejtin, kështu që i pandehuri me veprimet e tij, tek i dëmtuari ka shkaktuar mundim frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës.

## II.

I pandehuri .....

Sepse me datë 26.01.2019, rreth orës 01:50 minuta, në Gj....., në rrugën “.....”, i pandehuri A. R.. me përdorimin e atëqastshëm të dhunës, për shkak të një mosmarrëveshje dhe rastit të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore të pandehurit-tani të dëmtuarit....., ashtu që në shenjë hakmarrje del nga kafiteria “BON” dhe shkon pas të dëmtuarit të cilin e sulmon duke e goditur me grushte në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, mirëpo ndërhyjnë personat prezent dhe e largojnë të njejtin kështu që i pandehuri me veprimet e tij i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit.

-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës.

## III.

I pandehuri Xh.... A....

Sepse me datë 26.01.2019, rreth orës 23:05 minuta, në kafiterinë “....”, në lagjen “A....”, në Gj....., me përdorimin e atëqastshëm të dhunës për shkak të lëndimeve trupore që i janë shkaktuar djali të tij-të pandehurit R.... A....., me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit Sh.... R....., ashtu që në shenjë hakmarrje shkon në kafiterinë e lartcekur dhe e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me grushte në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit mirëpo ndërhyjnë personat që kanë qenë prezent dhe e largojnë të njejtin, kështu që i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit Sh..... R..... i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gj.....

-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,43,45,46,47,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 233,248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit e lartcekur:

I GJYKON

Të pandehurit R.... A...., për veprën penale si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri për periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprër tjetër penale.

Të paandehurit A... R...., për veprën penale si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën i pandehuri obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të pandehurin Xh.... A...., për veprën penale si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 47 të KPRK-ës i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën i pandehuri obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri A... R.... nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti llogaritet nga një ditë burgim ndërsa nëse i pandehuri Xh... A.... nuk e paguan dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë dënimi i zëvendësuar me gjobë do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç, që në bazë të nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të paguajnë shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për secilin prej tyre si dhe shpenzimet procedurale sipas përllogaritjes përfundimtare të gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 31.01.2019, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 143/2019, kundër të pandehurve R.... A.... për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, të pandehurit A.... R...., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës dhe të pandehurit Xh....A...., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës.

Së bashku me aktakuzë prokuroria kanë dorëzuar edhe Marrëveshjet mbi Pranimin e Fajësisë me numra PP.II.nr.143/2019, të datës 28.01.2019, të arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurve, R.... A...., A... R... dhe Xh.... A.... me mbrojtësit e tyre në anën tjetër, sipas të cilave marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar që të pandehurin R... A.... për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, ta shpallë fajtor dhe të njejtit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri për periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprër tjetër penale, të pandehurit A.... R.... për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-ës, ta shpallë fajtor dhe të njejtit ti shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën i pandehuri

obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe të pandehurin Xh.... A..... ta shpallë fajtor dhe të njejtit ti shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 47 të KPRK-ës të i zëvendësohet me dënim me gjobë.

## 2.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Me datë 22.05.2019, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimi fillestar, në të cilin ishin prezent prokurorja e shtetit Batije Ademi, i pandehuri R... A.... dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare M. M....., avokat nga Gj....., i pandehuri A.... R.... dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare....., avokat nga Gj, i pandehuri Xh... A.... dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare S. R., avokat nga Gj si dhe i dëmtuari Sh.... R.... ku pas dëgjimit të palëve lidhur me marrëveshjen, gjykata në bazë të nenit 233 paragrafi 21 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë me numra PP.II.nr.143/2019, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 233 paragrafi 18 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të pandehurve me mbrojtësit e tyre, i përmbushin të gjitha kushtet ligjore si dhe të njejtat janë arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë vullnetarisht pas konsultime të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale e rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPPRK-ës.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri R... A.... ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, i pandehurit A.... R...., ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi dhe i pandehuri Xh.... A....., ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi.

## 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit R... A...., A.... R.... dhe Xh..... A....., ti shpall fajtor dhe të njejtëve tui shqiptojë dënimet e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesve, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se të pandehurit kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në një fazë të hershme të procedurës penale, se secili prej tyre e kanë pranuar fajësinë për veprat penale të cilat iu në barrë, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga deklaratat mbi pranimin e fajësisë të cilat i janë bashkangjitur secilës prej marrëveshjeve së lartcekura, të njejtit janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre dhe kanë kërkuar falje për të njejtat veprime, gjykata mori parasysh edhe faktin se të njejtit kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla e as vepra të tjera penale po ashtu si rrethanë lehtësuar mori parasysh edhe rrethanat

personale si dhe karakterin e të dënuarve ku nga shkresat e lëndësi shihet se për të njejtit është hera e pare që bien ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se me veprimet e të pandehurit R.... A...., tek i pandehuri-i dëmtuari A.... R.... është shkaktuar mundim, frikë dhe shqetësim i madh emocional, nga veprimet e të pandehurit Ahmet Rudi, i pandehuri-i dëmtuari R... A...., ka pësuar lëndime të lehta trupore e po ashtu nga veprimet e të pandehurit Xh.... A...., i dëmtuari Sh.....R... ka pësuar lëndime të lehta trupore andaj gjykata konsideron me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura mund të arrihen edhe qëllimet e dënimit nga neni 41 të KPRK-së, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 6. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari Sh.... R....., në seancën e shqyrtimit fillestar të datës....., ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit Xh.... A... si dhe nuk ushtron kërkesë pasurore juridike, andaj edhe mbi këtë bazë gjykata nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

#### 7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve të lartcekur, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të ti detyrojë që në bazë të nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit për kompensimin e viktimave të secili prej tyre veç e veç të paguajnë shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro), si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro), për secilin prej tyre, të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.123/2019, me datë 22.05.2019

Procesmbajtësja  
Donika Latifi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.